



Prishtinë, 26 qershor 2024

Deklaratë publike

Sot më 26 Qershor, në Ditën Ndërkombëtare në Mbështetje të Viktimave të Torturës apelojmë që kryerësit me çrregullime mendore, të vendosen dhe trajtohen me dinjitet!

Sot shënohet Dita Ndërkombëtare në Mbështetje të Viktimave të Torturës. Më 26 Qershor të vitit 1987 hyri në fuqi Konventa e OKB-së Kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Degraduese, si një nga instrumentet kryesore në luftën kundër torturës dhe parandalimin e saj.

Në këtë vit Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës (QKRMT) shënon 25 vjetorin e themelimit të saj. Përgjatë kësaj kohe, QKRMT ishte dhe mbetet organizata më e përkushtuar ndaj viktimave – të mbijetuar të torturës, familjarëve dhe të afërmëve të tyre – duke iu ndihmuar atyre në përballimin e dhimbjeve dhe kërkimin e drejtësisë.

Në shënimin e **Ditës Ndërkombëtare në Mbështetjen e Viktimave të Torturës**, QKRMT rishtazi tërheq vëmendjen e opinionit publik vendor dhe ndërkombëtar për nevojën e respektimit të të drejtave të njeriut në vendet e privimit nga liria.

Viteve të fundit, QKRMT, rëndësi të veçantë i ka kushtuar vendosjes dhe trajtimit të kryerësve me çrregullime mendore. Numri i tyre është në rritje të vazhdueshme, ndërsa mungojnë institucionet përkatëse për vendosjen dhe trajtimin e kryerësve me çrregullime mendore. Në mungesë të institucioneve speciale për vendosjen e personave me çrregullime mendore, ata po mbahen në institucione korrektuese në kundërshtim me legjislacionin vendor dhe standardet ndërkombëtare.

Në Kosovë funksionon Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK) me 12 shtretër për ekzaminim psikiatrik dhe 24 shtretër për ekzekutimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, institucion ky që as për së afërmi nuk mund të iu përgjigjiet kërkesave për ekzaminim psikiatrik të paraburgosurve me probleme të shëndetit mendor.

Gjatë vitit 2023 është funksionalizuar edhe Institucioni Shëndetësor për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta (IShTPNV) apo Pavioni D në Qendrën Korrektuese në Dubravë, i cili ka vetëm 20 shtretër për vendosjen persona me çrregullime mendore, përkatësisht vetëm për rastet që kanë rrezik për vetëvrasje dhe për personat me çrregullime akute mendore.

Pra, në Kosovë nuk ka institucione të veçanta për ekzekutimin e masës së paraburgimit për personat me çrregullime mendore ashtu siç e përcakton Neni 509, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës penale: *“Paraburgimi mbahet në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe mund të zgjasë për aq kohë sa i pandehuri është i rrezikshëm, por që nuk kalon afatet e parapara për paraburgim në nenin 187 të këtij Kodi”*.

Aktualisht, të paraburgosurit me çrregullime mendore janë të vendosur thuajse në të gjitha institucionet korrektuese në Kosovë, praktikë kjo që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. QKRMT ka evidentuar raste kur kryerësit me çrregullime mendore janë lënduar, vetëlënduar si dhe kanë vdekur gjatë qëndrimit në qendrat e paraburgimit përderisa kanë pasur Aktvendim nga gjykata për vendosjen e tyre në IPFK, mirëpo në mungesë të shtretërve në IPFK ata janë vendosur në qendrat e paraburgimit.

Gjykata Evropiane për të Drejtata e Njeriut (GJEDNJ), thekson se shtetet duhet t’iu sigurojnë që kushtet e vendosjes për të burgosurit, veçanërisht ata me çrregullime mendore, të mos rezultojnë në vështirësi që tejkalojnë vuajtjen e qenësishme të burgimit. Sipas nenit 3 të Konventës, GJEDNJ-ja pohon se ***ndalimi i vazhdueshëm i një personi pa mbikëqyrjen dhe trajtimin e duhur mjekësor përbën trajtim çnjerëzor dhe degradues***, veçanërisht për të burgosurit me çrregullime të rënda mendore dhe prirje vetëvrasëse. Cenueshmëria dhe aftësia për të komunikuar ankesat duhet të merren parasysh kur vlerësohet përputhshmëria e kushteve të paraburgimit me standardet e Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore. Sipas GjEDNJ-së, ***shteti është i detyruar të marrë masa efektive, përfshirë trajtimin e specializuar dhe kushte të përshtatshme të paraburgimit, për individët me çrregullime mendore dhe t’i transferojë ata në mjedise të përshtatshme*** nëse kjo është e nevojshme. Për më tepër të bashkangjitur mund të gjeni hulumtimin e QKRMT-së ***“Obligimet e shtetit për trajtimin e kryerësve me çrregullime mendore”***, në të cilin është paraqitur baza ligjore dhe standardet ndërkombëtare për vendosjen dhe trajtimin e kryerësve me çrregullime mendore.

Prandaj, në Ditën Ndërkombëtare në Mbështetje të Viktimave të Torturës, QKRMT i bën thirrje institucioneve përgjegjëse që të marrë parasysh thirrjen tonë dhe urgjentisht t’i zbatojnë pikat e përmbledhura si më poshtë:

1. Rritja urgjente e kapaciteteve të institucioneve të specializuara

Institucionet shtetërore duhet të zhvillojnë politika për zgjerimin e kapaciteteve në Institutin e Psikiatrisë Forenzike. Përveç rritjes së kapaciteteve, duhet të bëhet dhe rregullimi ligjor i funksionimit të këtij instituti. Kjo vlerësohet si masë mëse e nevojshme me qëllim të mënjanimin të vonesave potencialisht kërcënuese për jetën e kryerësve me çrregullime të rënda mendore në institucionet korrektuese dhe qendrat e paraburgimit.

Sa i përket hapësirave akomoduese, institucionet shtetërore duhet ta trajtojnë me urgjencë krijimin e hapësirave adekuate për trajtimin e grave me çrregullime mendore dhe të miturve të cilat dyshohen për kryerje të veprave penale ose janë të dënuara.

2. Të ndalohet vendosja në institucione korrektuese/qendra të paraburgimit të personave me çrregullime mendore

Gjykatat dhe institucionet tjera shtetërore, vendimmarrjen ta bazojnë në një qasje të përqendruar te të drejtat e njeriut, duke harmonizuar politikat dhe praktikat me standardet ndërkombëtare për të mbrojtur dinjitetin dhe mirëqenien e individëve me probleme të shëndetit mendor në paraburgim. Duhet të ndalohet praktika e vendosjes në qendra të paraburgimit, mbi arsyetimin e mungesës së vendeve të lira në IPFK.

Institucionet përgjegjëse (Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e tjera relevante) urgjentisht duhet të ndërmarrin masa për krijimin e institucioneve të veçanta për vendosjen dhe trajtimin e kryerësve me çrregullime mendore.

Po ashtu, rekomandohet të dizajnohen dhe të mbahen trajnime të vazhdueshme për gjyqtarët dhe prokurorët, për ndërgjegjësimin e tyre për shkelësit me çrregullime mendore dhe rrezikun shëndetësor dhe ligjor të vendosjes së tyre në institucione pa mjedise adekuate të trajtimit dhe kujdesit shëndetësor.

E një rëndësie të veçantë është edhe trajnimi i stafit korrektues në lidhje me shëndetin mendor, psikologjinë, parandalimin e vetëvrasjeve, etj. Kjo do të ndikonte drejtpërdrejtë në forcimin e kapaciteteve për ofrimin e një trajtimi më adekuat për personat me çrregullime mendore nëpër institucionet e privimit nga liria.

3. Qasje e vazhdueshme në shërbime profesionale shëndetësore

Në rastet kur kryerësit me çrregullime mendore, edhe pse në kundërshtim me kërkesat ligjore, por janë të vendosur në institucionet korrektuese, duhet t'u sigurohet mbikëqyrje dhe kontrollë e vazhdueshme nga profesionistë shëndetësor. Në institucionet korrektuese, në masën më të madhe kryerësve me çrregullime mendore iu ofrohet trajtim farmakologjik, në mungesë të opsioneve tjera siç janë trajtimet psiko-sociale, terapi rehabilituese dhe okupacionale. Këto dhe programe tjera alternative janë shumë të nevojshme të zhvillohen dhe të implementohen në institucionet korrektuese dhe qendrat e paraburgimit.

